


Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	07.07.2014
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.K.
PËR/ZA/TO:	z. Faton Ademi – Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni – Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion - Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari ztr. Ademi

Lidhur me kërkesën tuaj të pranuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPK-03-2338/14), ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; *"bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave"*, (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).

Bazuar në kërkesën tuaj, se a ka konflikt interesi në rastet kur ju trajtoni lëndë në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, kur si përfaqësues i palës paraqitet avokati Zenel Ademi me të cilin keni një lidhje familjare, (sipas sqarimit tuaj jeni nga një trung i njejtë familjar; stërgjyshi i juaj dhe stërgjyshi i avokatit kanë qenë vëllezër), në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, për rastin e caktuar, kemi nxjerr këtë :

Faqe 1 nga 1

OPINION :

Nuk ka konflikt faktik ose të vazhdueshëm interesi, por ekziston konflikt i mundshëm interesi në ushtrimin e funksionit publik si Gjyqtar në Gjykatën Themelore, kur si përfaqësues i palës paraqitet Avokati me të cilin keni një lidhje familjare.

Për tu parandaluar ky konflikt i mundshëm interesi (rast për rast), ju si zyrtari i lartë publik jeni të obliguar që ta deklaroni atë dhe ta parandaloni.
Kjo po ashtu lidhet edhe me rregullat e etikës.

Ushtrimi i funksioneve publike nënkupton që zyrtarët e lartë nuk duhet që të lejojnë që interesat e tyre private të bien në konflikt me funksionet e tyre. Ata duhet të shmangun konfliktin e interesit, pavarisht nëse ai është real (faktik) apo i mundshëm.

Këtu do tu njoftojmë cilat situata konsiderohen konflikt interesi për zyrtarin dhe po ashtu, në bazë të kërkesës tuaj me numër protokoli të AKK-së DPKI-03-2338/14, do të përgjigjemi në pyetjen që ju e keni parashtruar në shkresën tuaj të datës 24.06.2014.

Përgjegjja në pyetjen tuaj del nga vet përkufizimi që Ligji për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i bënë nocionit “konflikt interesi”.

Se *çka është konflikti i interesit* është përkufizuar në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si vijon :

“Konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtëpërdrejta ose të tërrthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”.

Në rastin tuaj konkret nuk ka konflikt interesi faktik as të vazhdueshëm, sepse Avokati i caktuar po përfaqëson interesin e palës, dhe perderisa kjo nuk është e ndaluar me LPK, atëherë nuk paraqet as konflikt interesi.

Por, ekziston konflikt i mundshëm i interesit ose konflikt “rast për rast” në ushtrimin e funksionit publik.

Kjo ndodhë atëherë kur përmes Avokatit të caktuar mbrohet ndonjë interes që përfshinë edhe vet Gjyqtarin e çështjes.

Kjo është e rregulluar me Ligjin për Parandalimin e konflikti të interesit në tri paragrafe të nenit 13, si vijon:



1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur.

3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

Në rastin konkret situata për të cilën ju keni pyetur, obligon zyrtarin e lartë që në raste të tilla të bëjë deklarimin “rast për rast” të interesave private.

Po ashtu në Nenin 8 të Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit janë të përcaktuara detyrimet e zyrtarit të lartë për të shmangur situatat e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Me respekt,